



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS
SË BIZNESIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2019

Lënda: Kthim përgjigje.

I nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 10540 datë 19.06.2019 për informacion për funksione e bashkise për mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit të vogël nepermjet veprimtareve ju informojme se Bashkia Shkoder ne lidhje me kete funksion zhvillon nje sere aktivitetesh ne zbatim te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit në kuadër të promovimit të territorit, produkteve dhe resurseve të Bashkisë Shkodër sipas Njësive Administrative, ka zhvilluar një sërë aktivitetesh gjatë periudhes 6/10/2017 – 14/06/2019.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit siguron asistencë për hartimin e programeve të zhvillimit social ekonomik të Bashkisë. Siguron mbështetjen administrative të nevojshme për të kryer funksionet dhe politikat e zhvillimit ekonomik të saj. Koordinon bashkëpunimin mes administratës së Bashkisë dhe të gjitha institucioneve, organizatave dhe individëve të interesuar në fushën e zhvillimit.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar panairët si më poshtë ne kuader te promovimit te zonave te ndryshme te territorit te bashkise Shkoder .

6/10/2017 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Ana e Malit

20/10/2017 Panairi i produkteve agropërpunuese sipas Njësive Administrative

19/5/2018 Panair i promovimit të vlerave artistike, kulturore dhe i produkteve të territorit (për Njësinë Administrative Velipojë

10/08/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Dajç

5/10/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Ana e Malit

14/09/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Berdice

22/06/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Guri I Zi

28/09/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Rrethina

09/09/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Postribe

15/07/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Pult

06/07/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Shosh

09/06/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Shale

26/10/2018 Panairi i produkteve agropërpunuese sipas Njësive Administrative

14/06/2019 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Guri I Zi

17/05/2019 Panairi i produkteve agropërpunuese Nj. A. Ana e Malit

Keto panaire kane luajtur rol specifik ne promovimin e territorit dhe pasurive te ndryshme kulturore dhe natyrore te ketyre zonave duke krijuar keshtu edhe nje tradite per keto panaire duke nxitur pjesemarrjen e te gjithë te interesuarve.

Detyrat dhe përgjegjësitë për mbështetjen e iniciativave, programeve dhe projekteve në sektorin e zhvillimit ekonomik, janë:

- Identifikon mundësitë sektoriale për zhvillimin ekonomik (biznesit prodhues, tregtar, turizëm, punimeve artizanale, etj.)
- Kryen rolin e ndërlidhësit midis organizatave lokale, biznesit, individëve dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në lidhje me zhvillimin ekonomik lokal të zonës.
- Krijon partneritete me komunitetin për të zhvilluar dhe promovuar mundësitë e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të biznesit.
- Asiston organizatat lokale, bizneset dhe individët dhe i mbështet ato për të shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit lokal nëpërmjet projekteve të ndryshme.
- Asiston në projektet e zhvillimit për krijimin e vendeve të reja të punës.
- Identifikon kërkesat për zhvillim dhe trajnim të komunitetit në përputhje me mundësitë e zhvillimit ekonomik lokal.
- Bën kërkime dhe harton analiza për mundësitë e konkurrueshmërisë në treg të biznesit lokal.

Detyrat dhe përgjegjësitë për promovimin e zhvillimit ekonomik lokal dhe investimeve vendase dhe të huaja janë:

- Krijimi i rrjeteve të zhvillimit me qytete dhe rajone të tjera.
- Pjesëmarrja në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për promovimin e potencialeve, resurseve dhe planeve të zhvillimit të Bashkisë Shkodër.
- Merr pjesë në Hartimin e strategjisë së komunikimit për promovimin dhe zhvillimin e biznesit.
- Bashkëpunimi me sektorët e tjerë për të promovuar mundësi të ndryshme zhvillimi (turizëm, art, punime artizanale).
- Hartimi i broshurave dhe materialeve të tjera promocionale.
- Promovimi i përdorimit të shërbimeve private ndaj biznesit.
- Në bashkëpunim më Drejtorinë e Menaxhimit të Territorit identifikon zonat për investime sipas llojeve të tyre dhe përgatit materialet promovuese me informacion të detajuar për çdo zhvillues dhe investitor të interesuar.

- Identifikon dhe harton një data basë për të gjitha pronat publike dhe private me destinacion zhvillimin ekonomik në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve të Bashkisë.
- Identifikon mundësitë për thithjen e investimeve vendase apo të huaja.
- Asiston në negociatat për krijimin e bizneseve të përbashkëta, apo lehtëson procesin e alokimit të bizneseve të huaja në territorin e Bashkisë.
- Siguron asistencë në përgatitjen e planeve të biznesit.
- Ofron këshillim në lidhje me analizën e tregut dhe mundësive për zhvillim ekonomik.
- Siguron këshillim në zhvillimin e produktit dhe identifikimin e segmenteve të tregut.
- Asiston me plane marketingu.
- Kryen analiza financiare mbi planet e biznesit të propozuara.
- Ofron trajnime sipas nevojave për të asistuar në menaxhimin e biznesit.
- Dokumenton dhe arkivon të gjitha mundësitë për zhvillimin e biznesit lokal dhe mundësive të zhvillimit ekonomik.
- Bashkëpunon me institucione vendase dhe të huaja që mbështesin me skema financimi dhe ndihmë teknike biznesin.
- Në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e tjera të Bashkisë harton dhe përditëson kuadrin ligjor dhe të gjitha procedurat administrative për marrjen e lejeve dhe liçencave nga Bashkia dhe dokumenton procedurat e lejeve dhe liçencimit nga institucionet e tjera publike

Ne kuadër të kërkesave tuaja, ju informojmë që përveq të dhënave tona të cilat mund ti gjeni në faqen internetit të Bashkisë Shkodër, informacion më të detajuar dhe specifik për aktivitetet e zhvilluara mund të gjeni edhe ne faqen:

<http://buxheti.info/shkoder/>

Suksese në punën Tuaj.

KRYETAR

Voltana Ademi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Zv/KRYETAR

Fatbardh Sheqi